



I gatshëm/e gatshme për kopshtin e fëmijëve

Albanisch



Impressum

Herausgeberin und Copyright
Erziehungsdirektion des Kantons Bern
Amt für Kindergarten, Volksschule und Beratung
www.erz.be.ch/akvb, akvb@erz.be.ch

Illustrationen
Peter Gärtl, Thun

Fëmijë kanë nevojë për detyra me të cilat ata mund të rriten, shembuj, në të cilët ata mund të orientohen, komunitete, në të cilat ata ndihen në duar të sigurt.

Prof. dr. Gerald Hüther

Të dashur prindër,

fëmija juaj do të hyjë së shpejti në kopshtin e fëmijëve. Kjo është një kohë e rëndësishme, sepse fëmijët në këtë moshë mund të mësojnë lehtë dhe shpejt. Ne dëshirojmë t'ju japim sugjerime se si ju mund ta mbështetni fëmijën tuaj në zhvillimin e tij.

Për fëmijë të vegjël lidhja emocionale është qenësore për të mbijetuar. Nga natyra fëmijët dëshirojnë të mësojnë gjëra të reja dhe t'i hapin vetveten botës. Afërsia emocionale në familje u mundëson atyre që ta përballojnë mirë hapin në botë.

Shumë fëmijë kanë mundur të grumbullojnë tashmë përvoja të para gjatë lojës në grupe. Kështu p.sh. ata luajnë me motrat dhe vëllezërit e tyre, me fëmijët e komshinjve ose me fëmijë në grupin e lojës që vizitojnë ata; gjatë kësaj ata njohin edhe një person të ri referimi siç është p.sh. drejtuesja e grupit të lojës. Ata kthehen të gëzuar në shtëpi tek prindërit e tyre dhe kanë shumë gjëra për të pyetur dhe për të treguar.

Në kopshtin e fëmijëve fëmija juaj kalon shumë kohë me fëmijë të tjerë. Kjo është e re për fëmijën tuaj dhe përherë tërheqëse.

Nganjëherë ai duhet të presë derisa të ketë radhën dhe mund të tregojë diçka vetë. Fëmija juaj mëson që jo të gjithë njerëzit ndihen njësoj (ose janë njësoj) dhe gjëra të ndryshme janë të rëndësishme për ata.

Fëmijë në këtë moshë mësojnë në formë loje dhe mund të kuptojnë tashmë mirë bashkëlidhje dhe rregulla. Fëmijë të vegjël imitojnë.

Prandaj sjellja e prindërve dhe personave të tjerë referues të rritur është shumë e rëndësishme. Kush i jep shembull fëmijës së tij që ai le njerëzit e tjerë të mbarojnë fillimisht të folurit e tyre, e nxit vëmendjen dhe aftësinë e përqendrimit të fëmijëve.

Kontakti me veten dhe me të tjerët

Umgang mit sich und anderen

Fëmija juaj dëshiron të jetë bashkë me fëmijë të tjerë.

Rënia në ujdi, marrja parasysh, orientimi, durimi për të pritur: Këto janë të nevojshme për t' u orientuar në një grup. Në një grup loje ose në një kopsht ditor fëmijësh, fëmija juaj mund të ushtrojë kontaktin me bashkëmoshatarët. Lejoni që fëmija juaj të luajë edhe me fëmijë të tjerë në sheshin e lojërave. Ose ftoni fëmijë të tjerë në shtëpinë tuaj.

Fëmija juaj dëshiron të jetë pjesë e një bashkësie.

Në një grup të madh fëmijësh vajza juaj ose djali juaj duhet ta ndajë me fëmijët e tjerë vëmendjen e personit mësimor. Nganjëherë fëmija juaj duhet t' i lërë për më vonë nevojat e veta ose duhet të presë derisa ai të ketë radhën.

Fëmija juaj dëshiron t' i shprehë ndjenjat e tij.

Kjo është e mirë. Ndhmoni fëmijën tuaj që të perceptojë, emërtojë ndjenjat dhe t' i përdorë ato. I jepni atij gjithashtu njohuri që në sjelljen ndaj të tjerëve ekzistojnë kufi. Ashtu si fëmija juaj dëshiron të respektohet, ai duhet të mësojë të ketë respekt ndaj fëmijëve të tjerë dhe të rriturve.



Pavarësia dhe besimi

Selbstständigkeit und Vertrauen

Fëmija juaj dëshiron të bëjë gjëra vetë.

Jepini fëmijës suaj mundësi për të provuar gjëra dhe t' i bëjë vetë ato. Jepini fëmijës suaj p.sh. kohë që të vishet dhe zhvishet vetë. Edhe vajtja në banjë duhet të ushtrohet që fëmija juaj të mund ta bëjë atë vetë në kopshtin e fëmijëve. Ndhmoni fëmijën tuaj vetëm atje, ku ndihma është e nevojshme.

Fëmija juaj dëshiron të jetë i pavarur.

Kini besim në aftësitë e fëmijës suaj. I jepni kurajë fëmijës suaj që të provojë përsëri, nëse ai nuk ia arrin diçkaje dhe gëzohuni bashkë me të, nëse ai ia del diçkaje mbanë. Ushtroni p.sh. me fëmijën tuaj rrugën për në kopshtin e fëmijëve. Ose jepini atij porosi të thjeshtë si të boshatisë kutinë postare ose të rregullojë takëmet e dorës në sirtar.

Fëmija juaj dëshiron të provojë dhe të eksperimentojë.

I vini në dispozicion fëmijës suaj materiale si lapsede me ngjyra, letër, shkumës, tutkall, shirit ngjitës ose gërshërë. Edhe ndihma gjatë punimeve shtëpiake ose në kuzhinë - përgatitje, prerje, rrahje, larjen e sallatës - janë mundësi për të ushtruar shkathtësi dhe për të fituar përvojë.



Loja dhe të mësuarit

Spielen und Lernen

Fëmija juaj dëshiron të luajë.

Fëmija juaj dëshiron të entuziazmohet dhe të harrohet në lojë. Në lojë fëmija juaj mëson që të thellohet, të planifikojë diçka dhe të ndjekë një çështje për një kohë më të gjatë.

Jepini fëmijës suaj këtë hapësirë të lirë. Lejoni që ai të luajë dhe të eksperimentojë me materiale të ndryshme, edhe të përditshme. Të çmueshme janë edhe kohët, në të cilat ju luani me fëmijën.

Fëmija juaj dëshiron të mësojë.

Të mësuarit do të thotë që gjërat arrihen ose dështojnë dhe kjo përvojë duhet të ushtrohet dhe të thellohet. Fëmija juaj ka mësuar të ecë, sepse ai është ngritur gjithmonë, kur ishte rrëzuar. Ju mund ta mbështetni fëmijën tuaj duke e forcuar në të gjithë veprimtarinë e tij, duke e lavdëruar për atë që ia del mbanë dhe duke e inkurajuar të provojë gjëra të reja.

Fëmija juaj dëshiron.

Është e rëndësishme të dëshirojë. Por jo gjithmonë fëmija juaj merr atë që dëshiron. Ai duhet të mësojë të presë dhe të dijë të sillet me zhgënjimet. Mërzia ose inati janë pjesë të ndjenjave tona. Por persona ose materiali nuk duhet të vuajnë nga kjo. Aftësia që të lihen nevojat për më vonë mund ta bëjnë fëmijën tuaj të fortë.



Të komunikohet dhe të kuptohet

Sich verständigen und verstanden werden

Fëmija juaj dëshiron të komunikojë

Interesohuni për atë që fëmija juaj bën dhe përjeton dhe dëgjojeni atë. Bisedoni me atë për gjëra të përditshme dhe i shpjegoni atij çfarë jeni duke bërë ose çfarë ka vëzhguar fëmija juaj.

Fëmija juaj dëshiron të dëgjojë.

Shikoni bashkë me fëmijën tuaj libra me ilustrime, tregojini histori dhe këndoni këngë bashkë me atë. Përmes kësaj ai përjeton afërsi dhe e mëson gjuhën. Flisni me fëmijën tuaj patjetër në gjuhën tuaj amtare. Kur gjuha amtare është e forcuar të mësuarit e një gjuhe të dytë arrihet shumë më lehtë.

Fëmija juaj dëshiron të përjetojë gjuhën.

Fëmijë të vegjël nuk mund t' i mbajnë fjalët e reja në kujtesë, nëse ato ndërmjetësohen vetëm nëpërmjet mediave elektronike. Fëmijët kanë nevojë për njerëz të besuar rreth vetes, të cilët bisedojnë me ata. Nga një person referues ata mësojnë gjëra të reja për një kohë më të gjatë dhe mund ta përdorin atë më herët.



Lëvizja dhe gjumi

Bewegung und Schlaf

Fëmija juaj dëshiron të lëvizë.

Lejoni që fëmija juaj të ngjitet, të balancojë, të bëjë kollotumba ose të luajë me top. Dilni jashtë dhe zbulojeni së bashku me fëmijën tuaj natyrën, edhe kur bie shi.

Fëmija juaj dëshiron të flejë mjaft gjumë.

Për të përballuar jetën e përditshme në kopshtin e fëmijëve është e rëndësishme që fëmija juaj të ketë gjumë të pashqetësuar të natës prej dhjetë deri dymbëdhjetë orësh. Për të fituar forcë në mëngjes ka nevojë për një vakt mëngjesi të shëndetshëm dhe ngopës.

Fëmija juaj dëshiron rituale.

Një jetë e rregullt e përditshme me rituale të njëllojta, për shembull gjatë vakteve dhe gjatë shkuarjes në krevat, i jep fëmijës suaj mbështetje dhe siguri.



Nëse ju dëshironi të dini më shumë, ju gjeni informacione të mëtejshme nën: www.erz.be.ch/fit-fuer-den-kindergarten
Ne ju urojmë juve dhe fëmijës suaj një kohë të pangarkuar.

